

RISHPELLJE E KONKURSIT PUBLIK

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK) shpall rishpallje të konkursit publik për ofrues të shërbimeve profesionale për projektimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e faqes zyrtare të internetit të OIRK.

Konkursi i mëparshëm ishte anuluar për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, ndërsa tani po rihapet me kritere të përditësuara, të përshtatura me buxhetin aktual që disponon OIRK për zhvillimin e platformës.

Qëllimi i projektit

Krijimi i një platforme moderne, funksionale dhe të sigurt, e cila do të shërbejë si burim zyrtar informacioni për OIRK dhe si mjet efikas komunikimi me anëtarët, institucionet dhe publikun e gjerë.

Faqja e internetit duhet të përfshijë:

- Informata të përgjithshme për OIRK (misioni, struktura, organet drejtuese, etj.)
 - Lajme dhe aktivitete nga veprimtaria e Odës
 - Listën e inxhinierëve të licencuar dhe anëtarëve të OIRK, me mundësi kërkimi dhe filtrimi
 - Dokumente zyrtare: marrëveshje bashkëpunimi, rregullore, vendime dhe akte të tjera normative
 - Faqe kontakti me formular të integruar për komunikim të drejtpërdrejtë
 - Panel administrativ për menaxhimin e përmbajtjes nga stafi i OIRK
 - Dizajn modern dhe të përgjegjshëm (responsive), të përshtatshëm për të gjitha pajisjet (desktop, tablet, mobil)
 - Integrim automatik me rrjetet sociale – çdo postim i ri në faqe të publikohet automatikisht në platformat kryesore si Facebook dhe LinkedIn
-

Kriteret për aplikim:

- Eksperiencë e dëshmuar në zhvillimin e faqeve të internetit për institucione publike ose organizata profesionale

- Njohuri në fushën e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave personale
 - Zhvillimi i modulit për mirëmbajtje dhe përditësime pas lançimit të faqes
 - Aftësi për të ofruar trajnime të shkurtra për përdorimin e panelit administrativ
-

Dokumentet që duhet të dorëzohen:

- CV ose portofolio e kompanisë/individit aplikues
 - Referenca për projekte të ngjashme të realizuara
 - Propozim teknik me përshkrim të zgjidhjes së ofruar
 - Ofertë financiare dhe afati i realizimit
 - Oferta për mirëmbajtje mujore ose vjetore
-

Kriteret e vlerësimit të ofertave:

- 15% – Cilësia e propozimit teknik
 - 10% – Eksperienca dhe projektet e ngjashme
 - 60% – Çmimi i ofertës
 - 8% – Afati i realizimit
 - 7% – Mbështetja pas lançimit (support/maintenance)
-

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave:

 **27.05.2025, ora 15:00**

Ofertat dorëzohen në mënyrë elektronike në:

 odaeinxhinierëve@gmail.com

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni në të njëjtën adresë elektronike.